



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 13.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 13.12.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, “NNP CTA SH.P.K.” PRISHTINË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qerdhes së femijeve në fshatin Gadime” me Nr. të Prok: 613-20-2452-5-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “NNP CTA SH.P.K.” PRISHTINË, të dt. 13.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qerdhes së femijeve në fshatin Gadime” me Nr. të Prok: 613-20-2452-5-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për GOE “Al – Group SH.P.K. & Arberi-NS SH.P.K., Prishtinë, i datës 08.12.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 08.12.2020;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartpërmendur
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "NNP CTA SH.P.K." PRISHTINË, me datë 13.12.2020 ka parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i qerdhes së femijeve ne fshatin Gadime" me Nr. të Prok: 613-20-2452-5-2-1 ku ne kete aktivitet AK ka shpallur fitues.

GOE "Al – Group SH.P.K. & Arberi-NS SH.P.K. Prishtinë, **për shpërblim me kontratë**, të datës 08.12.2020 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Autoriteti Kontraktues, me datë 14.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

SQARIM:


AK. Drejtoria e Prokurimit ka bërë RIVLERSIMIN e ofertave pas pranimit te vendimit nga ana e OSHP me nr. 784-824/20 i dates: 16.11.2020 dhe ka marr vendim si mësipër per shperblim me kontrate GOE "Al – Group SH.P.K. & Arberi-NS SH.P.K. Prishtinë.


Te bashkangjitur keni edhe vendimin e OSHP-se, ku mund te orientoheni per te gjitha pikat per kete procedur.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Adem Duriqi
Drejtör i Prokurimit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TËLO ZA RAZMATRANJE

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br.

784-824/20

Data/Datum.

16.11.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TËLO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PRISHTINË - PRISTINA

PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.784/20

824/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenkovic - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik N.N.P “CTA”- SH.P.K- Prishtinë dhe OE “AL-Group” SH.P.K- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Engrup” SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime”, me nr. të prok: 613-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Lipjan”, më datën: 13.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: N.N.P “CTA”- SH.P.K- Prishtinë, dhe OE “AL-Group” SH.P.K- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime”, me nr. të prok: 613-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga AK- “KK-Lipjan”,

II. **ANULOHE**T, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime”, me nr. të prok: 613-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Lipjan”, dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: N.N.P “CTA”- SH.P.K- Prishtinë, dhe OE “AL-Group” SH.P.K- Prishtinë, aprovohen si të bazuara i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

AR SYETIM

Operatorët ekonomik ankues N.N.P "CTA"- SH.P.K- Prishtinë dhe OE "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 09.10.2020 me nr. 784/20 dhe me 19.10.2020 me nr. 824/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime", me nr. të prok: 613-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Lipjan", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 6, 7, 59, 60, 61, 69 dhe 72 të LPP-së, te ankesa me nr. 784/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 13, 52, 59, 60, 64, 69, 72 dhe 10 të LPP-së, te ankesa me nr. 824/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 28.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

OE N.N.P "CTA" SH.P.K Prishtinë – ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN – ka përcaktuar kushte dhe kritere për pjesëmarrje në kundërshtim me LPP-në: Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi pika 1 dhe 2, Dhe neni 51 -Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes pika 3.

Pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN – komisioni vlerësues dhe pika e cekur në letrën standarde për eliminim të datës 16.07.2020 Se: Tenderi juaj është eliminuar për arsye se të kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional vendimin apo deklaratën për emërimin e menaxherit e keni në emër të inxhinierit të diplomuar të

ndërtimtarisë-drejtimin konstruktive, ndërsa sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me drejtimin e arkitekturës. Si dhe pretendimi. Në si ofertues kemi caktuar menaxher të projektit inxhinierin e ndërtimtarisë Zija MORINA që ka qen një gabim minor që nuk paraqet devijim të madh sepse në listën e stafit kemi të prezantuar edhe inxhinierin e arkitekturës master të cilin mund ta caktojmë menaxher të projektit.

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH nr. 506/20 dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkojë informata shtese. OE "CTA" SHPK ka caktuar menaxher të projektit inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë Zija MORINA dhe thotë se ka qen një gabim minor që nuk paraqet devijim të madh sepse në listën e stafit kemi të prezantuar edhe inxhinierin e arkitekturës master të cilin mund ta caktojmë menaxher të projektit. Ndërsa sipas kërkesës në njoftimin për kontratë është kërkuar të jetë Inxhinier i diplomuar i arkitekturës Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor nuk qëndron pasi që OE ka caktuar menaxher të projektit staf profesional me profesion në kundërshtim me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimin nr. 2

Lidhur me pretendimin e OE N.N.P "CTA" SHPK- Prishtinë – ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN – komisioni vlerësues dhe pika e cekur në letrën standarde për eliminim të datës 16.07.2020 në të cilën thuhet se: Tenderi juaj është eliminuar për arsye se të kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional licencën e gjeodetit e keni me afat të skaduar OE ankues në ankesën thotë se AK nuk ka respektuar RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK. Neni 39. Sqarimi i Tenderëve pika 39.5 si dhe Neni 72 të LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar

më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH .nr. 506/20 dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkojë informata shtese. AK-ja në bazë të dokumentacionit të ofruar nuk ka kërkuar informata shtese nga OE- ankues siç është kërkuar. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN – komisioni vlerësues, se oferta e OE e shpallur fitues nuk i plotëson kriterin e kërkuar të Kapaciteti teknik dhe profesional Në njoftimin për kontratë dhe dosje tenderit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në shumën prej 370,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrata (në rast të grupit (konzorciumit) lideri duhet ti ketë së paku 60% të kërkesës). Gjatë shikimit në listën e OE ENGRUP shpk të shpallur fitues kemi hasur në projekte jo të ngjashme të cilat i keni vlerësuar si projekte të ngjashme lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku aktiviteti i prokurimit i përket ndërtimit të lartë ndërsa kontrata prezantuese janë të ndërtimit të ulët.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH .nr. 506/20 dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkojë informata shtese AK- me datën 01.10.2020 nga OE "ENGRUP" SH.P.K ka kërkuar informatë shtese siç është kërkuar në bazë të vendimit të PSH-se nr. 506/20, OE i ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar me datën 05.10.2020 dhe i plotëson kriterin e kërkuar të Kapaciteti teknik dhe profesional Në njoftimin për kontratë dhe dosje tenderit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në shumën prej 370,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN – komisioni vlerësues se oferta e OE e shpallur fitues "ENGROUP" SH.P.K. nuk i plotëson

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale KERKESA NGA AK Kërkesa 2. j) Min. 7 punëtor të certifikuar në lëmin e ndërtimit si Armirues, Murator, Molerues, Suvatim, Ngrohje, Hidroteknike dhe Elektroteknike. Dëshmia e kërkuar: Për piken J. Të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional. Për të gjithë punëtorët kërkohen kontratat e punës ose para kontratë për këtë projekt. Autoriteti kontraktues mban të drejtën e verifikimit të Certifikatave të kërkuara,

OE e shpallur fitues "ENGROUP" SH.P.K nuk ka dorëzuar certifikata siç është kërkuar në dosje të tenderit për punëtorët nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional por ka dorëzuar Diploma. nuk e plotëson kushtin e AK që OE duhet të dorëzojnë certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH nr. 506/20 dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkojë informata shtese AK-ja në bazë të dokumentacionit të ofruar në shqyrtim nuk ka kërkuar informata shtesë nga OE- ankues siç është kërkuar me Vendimin e PSH nr. 506/20.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë

Pretendimi nr. 1

Autoriteti Kontraktues ka shpallur Fitues OE "ENGRUP" SHPK ku ky OE ka shkelur Nenin 10 të Kontrata e punës- Ligji i punës Nr.03/ L-212. OE në fjale ka lidhur kontrate për Shërbime e cila është kontrate jo ligjore sipas këtij ligji. Këto kontrata janë lidhur me Inxh. N. Jusufi, Inxh. S. Lipovica, Inxh. A. Abazi, Inxh. V. Mustafa, Inxh. S. Misini, Inxh. G. Halili, Inxh. V. Ramadani Kontratat e këtyre inxhinierëve janë kontrata të pavlefshme. Kjo e bene OE të papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se KONTRATA PER KRYERJEN E SHËRBIMEVE e lidhur me Inxh. N. Jusufi, Inxh. S. Lipovica, Inxh. A. Abazi, Inxh. V. Mustafa, Inxh. S. Misini, Inxh. G. Halili, Inxh. V. Ramadani për të cilat Operatori Ekonomik Ankues ka pretendime, janë të

lidhur ne mënyrë te rregullt ne vete përmbajnë nenet e nevojshme te cilat tregojnë qarte detyrat dhe përgjegjësit e punëtorit si dhe punëdhënësit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 2

Autoriteti Kontraktues ka shpallur fitues OE "ENGRUP" SHPK ku gjate vlerësimit AK është dashur qe te kërkojë vazhdimin e validitetit te Licencës se Gjeodetit G. Halili mirëpo AK nuk e ka kërkuar. Ku kjo e bene OE te papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH .nr. 506/20 dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkoj informata shtese. AK-ja ne baze te dokumentacionit te ofruar nuk ka kërkuar informata shtese nga OE- ankues siç është kërkuar. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 3

Gjatë qasjes ne dokumente kemi pare qe AK nuk ka kërkuar informata Shtese për Certifikatat e Punëtorëve Teknik sipas Vendimit te Panelit Shqyrtues 506/20 ku thotë se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkojë informata shtese se a janë te vlefshme këto diploma konform kërkesës se AK-se te shpallur ne njoftimin për kontrate dhe dosjes te tenderit ku OE ne fjale nuk ka ofruar Certifikatat e Punëtorëve Teknik nga Qendrat e licencuara për Aftësim Profesional. Gjenerali te bashkangjitura Letrën Standarde për Sqarimin e tenderit për te cilën AK nuk ka kërkuar informata për këto Certifikata. Ne kemi Komunikuar edhe përmes E-Mailit me zyrtare nga Ministria e Arsimit ne lidhje me këto diploma dhe kemi pyetur se a janë nga qendra te licencuara. Ministria e ka konfirmuar qe këto diploma nuk janë lëshuar nga institucioni i licencuar nga MASH dhe kjo e bene OE te papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me

pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH .nr. 506/20 dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkoj informata shtese, AK-ja në bazë të dokumentacionit të ofruar në shqyrtim nuk ka kërkuar informata shtesë nga OE-ankues siç është kërkuar me Vendimin e PSH nr. 506/20. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar

Pretendimi nr. 4

AK ka vlerësuar OE në fjale të përgjegjshëm edhe pse nuk ka përmbushur kërkesën në numër 6.4 të FTD-se Përshtatshmëria e Operatoreve Ekonomik pika c) Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit. Ku AK ka shpallur fitues një OE i cili ka ofruar këtë vërtetim të datës 06.05.2020 ndërsa vendimi i AK është i datës 06.10.2020 që i bie ky vërtetim është i 153 ditëve apo ndryshe 5 muajve jo 3-mujorit të fundit sipas kërkesës të FTD-se. Ku kjo e bene OE të papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se operatori ekonomik i propozuar për kontratë ka dorëzuar Certifikatën të lëshuar dt. 06.05.2020 nga GJTHK- Departamenti për çështje Ekonomike me datën 15.07.2022 përmes platformës e-Prokurim sipas Kërkesës së Përshtatshmërisë së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në të cilën kërkohet: c) Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimet për Operatorin Ekonomik: N.N.P “CTA” SH.P.K.-Prishtinë

Pretendimi nr. 1

OE në fjale ka Bashkangjitur Bachelor për Menaxhimin e Emergjencave E. Mirena ku ky OE ka bashkangjitur CV të tjetër inxhinierit dhe modifikimi i fundit shihet qartas që nuk i takon kjo CV këtij Inxhinieri pavarësisht nënshkrimit të vendosur kjo CV i takon Q. Qehaja ku OE në fjale edhe ka vendos numrin e kompanisë si dhe e-mailin e kompanisë për kontakt. Po ashtu në CV është e paraqitur se inxhinieri E. Mirena është Inxhinier i Makinerisë e jo inxhinier i Emergjencave. Kjo CV është CV e kombinuar në mes Q. Qehaja si dhe B. Kryeziut.

Ne baze te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim publik ceket: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm. Kjo e bene OE te papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim sqaron se CV-ja e Emin Morena nuk i plotëson Kriteret e kërkuar ne baze te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kërkesa 2. Stafi Profesional - dëshmia: b).Për stafin profesional nga pika A. deri G. te dëshmohen me CV te nënshkruar nga vet inxhinieri, sepse ne CV-te e tyre ka te dhëna te pasakta dhe te emrat si dhe profesionet e tyre. Ne baze te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim publik ceket: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat- Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm. Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 2

OE ne fjale ka Prezantuar z. M. Mustafa Inxhinier te Gjeodezisë ku OE nuk ka ofruar diplomën e përkthyer për këtë inxhinier pasi qe gjuha Kroate nuk është gjuhe zyrtare Neni 13 LPP-së Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik. Kjo e bënë OE të papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se operatori ekonomik i propozuar për kontratë në ofertën e dorëzuar, ne listën e stafit ka ofruar z. M. Mustafa Inxhinier te Gjeodezisë ku OE ka ofruar diplomën për këtë inxhinier ne gjuhen Kroate. Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim: Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton: Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmartje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze". Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përsëritet në format standarde të miratuara në bazë të LPP-së. Sipas dispozitave të lartpërmendura tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur. Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së. Si rrjedhojë, bazuar në nenin 13 të LPP-së dhe format standarde (dokumentet e tenderimit), KRPP ofron këtë opinion:

Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësoj tenderin. Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim:

1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht;

Pra, sjellja e OE që sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë dhe plotësisht e pavarur nga një dispozitë e veçantë në dokumentet e tenderit.

3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit.

Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.

Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohej nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të njëjtit dokument. Duke u bazuar në këto fakte ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr. 3

OE në fjale ka ofruar licencën jo Valide të Inxhinierit të Gjeodezisë M.Mustafa. Ku kërkesa në FTD PIKA 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale Kërkesa 2. Dëshmia2 pika B kërkohej licenca për gjeodet me validitet. Kjo e bene OE te papërgjegjshëm

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtuar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH .nr. 506/20 dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkoj informata shtese. AK-ja ne

baze te dokumentacionit te ofruar nuk ka kërkuar informata shtese nga OE- ankues siç është kërkuar. Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr. 4

OE në fjale ka ofruar Murator dhe punëtorë i certifikuar në lëminë e kantierit R. Shabani shihet qartas që nënshkrimi i Para Kontratave të njëjta nuk përputhet me njëra tjetrën. Ku në vend që të jetë nënshkrimi i R. Shabani është nënshkrimi i V. Dedinca. Ku kjo e bënë OE të papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se ne Para-Kontratën e lidhur ne mes te NNP "CTA" SHPK dhe Ragip Shabani për projektin me titull: Ndërtimi i qerdhes se fëmijëve ne fshatin Gadime 613-20-2452-5-2-1 me te cilën Vërtetojnë se Gentrin Ademaj punëtor i certifikuar....., kurse është nënshkruar nga Ragip Shabani. Pra siç shihet Para-Kontrata është lidhur ne mes te NNP "CTA" SHPK dhe Ragip Shabani dhe jo me Gentrin Ademaj, për te cilin është përcaktuar dhe pozita e vendit te punës.

Ne te njëjtën formë janë lidhur dhe Para-Kontrata ne emër te Vesat Dedinca, Nysret Shillova, Hashim Bojaxhiu dhe Fazli Gjyliqi, OE gjatë punimit të Para-Kontratave nuk ka qen i kujdesshëm në plotësimin e tyre, si dhe kontraktoret te cilët kanë nënshkruar dokument – "Para- Kontrate" e cili nuk ju përket atyre. Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 5

Bujar Kryeziu është paraqitur si inxhinier i makinerisë ndërsa ne CV është paraqitur emri i Q. Qehaja ku kjo CV është e njëjtë me Bachelorin e Emergjencave E. Mirena.

Ne baze te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim publik ceket: CV-je dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm. Ku kjo e bënë OE te papërgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 5

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se CV-ja e Bujar Kryeziu-t nuk i plotëson Kriteret e kërkuar ne baze te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kërkesa 2. Stafin Profesional - dëshmia: b).Për stafin profesional nga pika A. deri G. te dëshmohen me CV te nënshkruar nga vet inxhinieri, sepse ne CV-te e tyre ka te dhëna te pasakta dhe te emrat si dhe profesionet e tyre, Ne bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim publik ceket: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm. Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 6

OE CTA SHPK ka emëruar menaxher të projektit Inxh. Z. Morina ku në FTD- pika 9.1 & 9.2 Tek **kërkesat** mbi mundësitë teknike dhe profesionale kërkohet që menaxher i Projektit të jetë inxhinier i Arkitekturës e jo inxhinier i ndërtimtarisë. Ku kjo e bënë OE të përgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 6

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH nr. 506/20 dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkojë informata shtese. OE "CTA" SH.P.K ka caktuar menaxher të projektit inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë Zija MORINA. Ndërsa sipas kërkesës në njoftimin për kontratë është kërkuar të jetë Inxhinier i diplomuar i arkitekturës. Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor qëndron pasi që OE ka caktuar menaxher të projektit staf profesional me profesion në kundërshtim me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si të bazuara, të ANULOHEM Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 06.10.2020 dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 30.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik N.N.P "CTA" SH.P.K.-Prishtinë me datë 29.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje të nderuar: Nuk e pranojmë ekspertizën me nr. 784-842-20, kërkojmë nga Kryetari z. Blerim Dina të caktoj një ekspert tjetër për këtë lëndë. Pasi që eksperti z. Daut Retkoceri nuk e ka trajtuar lenden drejte ka lenë disa çështje pa i trajtuar fare duke i vete gjykuar si të pa rëndësishme, duke favorizuar OE të shpallur fitues dhe OE tjetër ankues, po ashtu jemi në mendim kundër vendimit me nr. 506/20, për pretendimin tonë me nr. 1 i cili është trajtuar me parë, po ashtu pretendimin nr. 5 e le pa trajtuar fare etj. Me respekt: idn . Zija MORINA.

Operatori Ekonomik "Al-Group" SH.P.K.-Prishtinë me datë 29.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE N.N.P "CTA" SH.P.K Prishtinë, se AK ka përcaktuar kushte dhe kritere për pjesëmarrje në kundërshtim me LPP-në, neni 7 pika 1 dhe 2, si dhe neni 51 pika 3, ku AK e ka eliminuar për arsye se të kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional, vendimin apo deklaratën për emërimin e menaxherit e keni në emër të inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë-drejtimin konstruktiv, ndërsa sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me drejtimin e arkitekturës. Si dhe pretendimi: ne si ofertues kemi caktuar menaxher të projektit inxhinierin e ndërtimtarisë Zija MORINA që ka qenë një gabim minor që nuk paraqet devijim të madh sepse në listën e stafit kemi të prezantuar edhe inxhinierin e arkitekturës master të cilin mund ta caktojmë menaxher të projektit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë me vendimin PSH.nr.506/20 të dt. 17.09.2020, në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj informata shtesë.

Sa i përket pikës tjetër ankimore të OE "CTA" SHPK se ka caktuar menaxher të projektit inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë Zija MORINA dhe thotë se ka qenë një gabim minor që nuk paraqet devijim të madh sepse në listën e stafit kemi të prezantuar edhe inxhinierin e arkitekturës master të cilin mund ta caktojmë menaxher të projektit. Ndërsa sipas kërkesës në njoftimin për kontratë është kërkuar të jetë Inxhinier i diplomuar i arkitekturës, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor nuk qëndron pasi që OE ka caktuar menaxher të projektit staf profesional me profesion në kundërshtim me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues N.N.P "CTA" SHPK – Prishtinë, se AK e ka eliminuar me arsyetimin se tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional licencën e gjeodetit e keni me afat të skaduar OE ankues në ankesën, thotë se AK nuk ka respektuar Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 39. Sqarimi i Tenderëve pika 39.5 si dhe Neni 72 të LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me vendimin PSH.Nr.506/20 të dt. 17.09.2020, në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj informata shtesë. AK-ja në bazë të dokumentacionit të ofruar nuk ka kërkuar informata shtesë nga OE ankues siç është kërkuar. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues NNP "CTA" SHPK Prishtinë, se AK e ka eliminuar me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuar të Kapaciteti teknik dhe profesional, në njoftimin për kontratë dhe dosje tenderit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në shumën prej 370,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrata (në rast të grupit (konzorciumit) lideri duhet ti ketë së paku 60% të kërkesës). Gjatë shikimit në listën e OE ENGRUP shpk të shpallur fitues kemi hasur në projekte jo të ngjashme të cilat i keni vlerësuar si projekte të ngjashme lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku aktiviteti i prokurimit i përket ndërtimit të lartë ndërsa kontrata prezantuese janë të ndërtimit të ulët.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullorës nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë,

kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me vendimin PSH.nr.506/20 të dt. 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj informata shtesë. AK me datën 01.10.2020 nga OE "ENGRUP" SH.P.K ka kërkuar informatë shtesë siç është kërkuar në bazë të vendimit PSH.nr.506/20, OE i ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar me datën 05.10.2020 dhe i plotëson kriterin e kërkuar të Kapaciteti teknik dhe profesional. Në njoftimin për kontratë dhe dosje tenderit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në shumën prej 370,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues NNP "CTA" SHPK Prishtinë, OE i shpallur fitues "ENGROUP" SH.P.K. nuk i plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkesa nga AK Kërkesa 2. j) Min. 7 punëtor të certifikuar në lëmin e ndërtimit si Armirues, Murator, Molerues, Suvatim, Ngrohje, Hidroteknike dhe Elektroteknike. Dëshmia e kërkuar: Për piken J. Të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional. Për të gjithë punëtorët kërkohej kontratat e punës ose para kontratë për këtë projekt. Autoriteti kontraktues mban të drejtën e verifikimit të Certifikatave të kërkuara. OE e shpallur fitues "ENGROUP" SH.P.K nuk ka dorëzuar certifikata siç është kërkuar në dosje të tenderit për punëtorët nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional por ka dorëzuar Diploma. nuk e plotëson kushtin e AK që OE duhet të dorëzojnë certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me vendimin PSH.nr.506/20 të dt. 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj informata shtesë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të shkresave të lëndës dhe dokumentacionit të ofruar në shqyrtim, AK nuk ka kërkuar informata shtesë nga OE ankues siç është kërkuar me Vendimin e PSH nr. 506/20. Prandaj, ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, se AK ka shpallur fitues OE "ENGRUP" SHPK, ku ky OE ka shkëlur Nenin 10 të Kontrata e punës- Ligji i punës Nr.03/ L-212. OE në fjalë ka lidhur kontratë për shërbime, e cila është kontratë jo ligjore sipas këtij ligji. Këto kontrata janë lidhur me Inxh. N. Jusufi, Inxh. S. Lipovica, Inxh. A. Abazi, Inxh. V. Mustafa, Inxh. S. Misini, Inxh. G. Halili,

Inxh. V. Ramadani. Kontratat e këtyre inxhinierëve janë kontrata të pavlefshme. Kjo e bënë OE të papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kontrata për kryerjen e shërbimeve e lidhur me Inxh. N. Jusufi, Inxh. S. Lipovica, Inxh. A. Abazi, Inxh. V. Mustafa, Inxh. S. Misini, Inxh. G. Halili, Inxh. V. Ramadani, për të cilat operatori ekonomik ankues ka pretendime, janë të lidhura në mënyrë të rregullt, përmbajnë nenet e nevojshme të cilat tregojnë qartë detyrat dhe përgjegjësit e punëtorit si dhe punëdhënësit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, se autoriteti kontraktues ka shpallur fitues OE "ENGRUP" SHPK, ku gjatë vlerësimit AK është dashur që të kërkojë vazhdimin e validitetit të Licencës së Gjeodetit G. Halili mirëpo AK nuk e ka kërkuar. Ku kjo e bënë OE të papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në rregulloren nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin PSH.nr.506/20 të dt. 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkojë informata shtesë. AK-ja në bazë të dokumentacionit të ofruar nuk ka kërkuar informata shtesë nga OE ankues siç është kërkuar. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin tjetër të OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, se gjatë qasjes në dokumente kemi parë që AK nuk ka kërkuar informata shtesë për certifikatat e punëtorëve teknik sipas vendimit të Panelit Shqyrtues 506/20, ku thotë se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkojë informata shtesë se a janë të vlefshme këto diploma konform kërkesës së AK-së të shpallur në njoftimin për kontratë dhe dosjes të tenderit, ku OE në fjalë nuk ka ofruar certifikatat e punëtorëve teknik nga Qendrat e licencuara për Aftësim Profesional. Gjeni të bashkangjitura Letrën Standarde për Sqarimin e tenderit për të cilën AK nuk ka kërkuar informata për këto Certifikata. Ne kemi Komunikuar edhe përmes E-Mailit me zyrtarë nga Ministria e Arsimit në lidhje me këto diploma dhe kemi pyetur se a janë nga qendra të licencuara. Ministria e ka konfirmuar që këto diploma nuk janë lëshuar nga institucioni i licencuar nga MASH dhe kjo e bënë OE të papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me vendimin PSH.nr.506/20 të dt. 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj informata shtesë. AK-ja në bazë të dokumentacionit të ofruar në shqyrtim nuk ka kërkuar informata shtesë nga OE siç është kërkuar me Vendimin e PSH nr. 506/20. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se pretendim i OE ankues lidhur me mos kërkesën e AK-së për certifikata është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, se AK ka vlerësuar OE të rekomanduar për kontratë si të përgjegjshëm edhe pse nuk ka përmbushur kërkesën në numër 6.4 të FTD-së Përshtatshmëria e Operatoreve Ekonomik pika c) Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit. Ku AK ka shpallur fitues një OE i cili ka ofruar këtë vërtetim të datës 06.05.2020 ndërsa vendimi i AK është i datës 06.10.2020 që i bie ky vërtetim është i 153 ditëve apo ndryshe 5 muajve, jo 3-mujorit të fundit sipas kërkesës të FTD-se. Ku kjo e bënë OE të papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i propozuar për kontratë ka dorëzuar certifikatën të lëshuar me dt. 06.05.2020 nga GJTHK- Departamenti për çështje ekonomike, me datën 15.07.2020 përmes platformës e-Prokurim sipas Kërkesës se Përshtatshmërisë se dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë ne te cilën kërkohet: c) Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Sa i përket pretendimeve të OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, kundër ofertës së OE N.N.P "CTA" SH.P.K.-Prishtinë se ka bashkangjitur Bachelor për Menaxhimin e Emergjencave E. Mirena, ku ky OE ka bashkangjitur CV e tjetër inxhinierit dhe modifikimi i fundit shihet qartë që nuk i takon kjo CV këtij Inxhinieri pavarësisht nënshkrimit të vendosur, kjo CV i takon Q. Qehaja, ku OE në fjale edhe ka vendos numrin e kompanisë si dhe e-mailin e kompanisë për kontakt. Po ashtu, në CV është e paraqitur se inxhinieri E. Mirena është Inxhinier i Makinerisë e jo inxhinier i Emergjencave. Kjo CV është CV e kombinuar në mes Q. Qehaja si dhe B. Kryeziut. Në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim publik ceket: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Kjo e bene OE te papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se CV-ja e Emin Morena nuk i plotëson Kriteret e kërkuara në bazë të kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kërkesa 2. Stafi Profesional - dëshmia: b).Për stafin profesional nga pika A. deri G. te dëshmohen me CV te nënshkruar nga vet inxhinieri, sepse në CV-të e tyre ka të dhëna të pasakta dhe te emrat si dhe profesionet e tyre, në bazë të Rregullave dhe

Udhëzuesit Operativ për prokurim publik ceket: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Duke u bazuar në këto fakte, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, se OE N.N.P "CTA" SH.P.K.- Prishtinë ka prezantuar z. M. Mustafa Inxhinier të Gjeodezisë, ku OE nuk ka ofruar diplomën e përkthyer për këtë inxhinier pasi që gjuha Kroate nuk është gjuhë zyrtare Neni 13 LPP-së Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik. Kjo e bënë OE të papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i propozuar për kontratë në ofertën e dorëzuar, në listën e stafit ka ofruar z. M. Mustafa Inxhinier të Gjeodezisë, ku OE ka ofruar diplomën për këtë inxhinier në gjuhën Kroate. Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim: Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton: Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze". Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përsëritet në format standarde të miratuara në bazë të LPP-së. Sipas dispozitave të lartpërmendura tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur. Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së. Si rrjedhojë, bazuar në nenin 13 të LPP-së dhe format standarde (dokumentet e tenderimit), KRPP ofron këtë opinion:

Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësoj tenderin. Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim:

1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e operatorëve të huaj ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht.

Pra, sjellja e OE që sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë dhe plotësisht e pavarur nga një dispozitë e veçantë në dokumentet e tenderit.

3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit.

Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.

Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohej nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të njëjtit dokument. Duke u bazuar në këto fakte, paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim I OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, se OE N.N.P "CTA" SH.P.K.- Prishtinë ka ofruar licencën jo valide të Inxhinierit të Gjeodezisë M.Mustafa. Ku kërkesa në FTD PIKA 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale Kërkesa 2. Dëshmia2 pika B kërkohej licenca për gjeodet me validitet. Kjo e bene OE te papërgjegjshëm

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me vendimin PSH.nr.506/20 të dt 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkojë informata shtese. AK-ja në baze të dokumentacionit të ofruar nuk ka kërkuar informata shtese nga OE- ankues siç është kërkuar. Duke u bazuar në këto fakte, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim I OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimit tjetër i OE ankues "AL-Group" SH.P.K- Prishtinë, se OE N.N.P "CTA" SH.P.K.-Prishtinë ka ofruar Murator dhe punëtorë të certifikuar në lëminë e kantierit R. Shabani shihet qartas që nënshkrimi i Para Kontratave të njëjta nuk përputhet me njëra tjetrën. Ku në vend që të jetë nënshkrimi i R. Shabani është nënshkrimi i V. Dedinca. Ku kjo e bënë OE të papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në para-Kontratën e lidhur në mes të NNP "CTA" SHPK dhe Ragip Shabani për projektin me titull: Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Gadime 613-20-2452-5-2-1 me të cilën Vërtetojnë se Gënitrit Ademaj punëtor i certifikuar....., kurse është nënshkruar nga Ragip Shabani. Pra, siç shihet para-Kontrata është lidhur në mes të NNP "CTA" SHPK dhe Ragip Shabani dhe jo me Gënitrit Ademaj, për të cilin është përcaktuar dhe pozita e vendit të punës. Në të

njëjtën formë janë lidhur dhe para-Kontrata në emër të Vesat Dedinca, Nysret Shillova, Hashim Bojaxhiu dhe Fazli Gjyliqi, OE gjatë punimit të para-Kontratave nuk ka qenë i kujdesshëm në plotësimin e tyre, si dhe kontraktorët të cilët kanë nënshkruar dokument – “Para- Kontrate” e cili nuk ju përket atyre. Duke u bazuar në këto fakte, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “AL-Group” SH.P.K- Prishtinë, se OE N.N.P “CTA” SH.P.K.-Prishtinë ka paraqitur Bujar Kryeziu si inxhinier i makinerisë ndërsa në CV është paraqitur emri i Q. Qehaja, ku kjo CV është e njëjtë me Bachelorin e Emergjencave E. Mirena. Në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim publik ceket: CV-je dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm. Ku kjo e bënë OE të përgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se CV-ja e Bujar Kryeziu-t nuk i plotëson Kriteret e kërkuara në bazë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kërkesa 2. Staf Profesional - dëshmia: b).Për stafin profesional nga pika A. deri G. të dëshmojnë me CV të nënshkruar nga vet inxhinieri, sepse në CV-të e tyre ka të dhëna të pasakta dhe të emrat si dhe profesionet e tyre, në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim publik ceket: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm. Duke u bazuar në këto fakte, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të fundit të OE ankues “AL-Group” SH.P.K- Prishtinë, se OE N.N.P “CTA” SH.P.K.-Prishtinë ka emëruar menaxher të projektit Inxh. Z. Morina, ku në FTD-pika 9.1 & 9.2 Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale kërkohet që menaxher i Projektit të jetë inxhinier i Arkitekturës e jo inxhinier i ndërtimtarisë. Ku kjo e bënë OE të përgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me vendimin PSH.nr.506/20 të dt. 17.09.2020 në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj informata shtesë. OE “CTA” SH.P.K ka caktuar menaxher të projektit inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë Zija MORINA. Ndërsa sipas kërkesës në njoftimin për kontratë është kërkuar të jetë Inxhinier i diplomuar i arkitekturës, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor qëndron pasi që OE ka caktuar menaxher të projektit staf profesional me profesion në kundërshtim me kërkesën në njoftimin për

kontratë dhe dosjen e tenderit. Andaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të dosjes së tenderit, si dhe nuk ka marrë parasysh udhëzimet e dhëna në vendimin e Panelit Shqyrtues PSH.nr.506/20 të datës 17.09.2020. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 për përgjigjet që janë dhënë në pretendime ankimore, dhe pastaj të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Lipjan";
- 1x1 OE N.N.P "CTA"- SH.P.K- Prishtinë;
- 1x1 OE "Al-Group" SH.P.K.-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.